

A woman with a glitch effect, wearing a red and green striped shirt and a black skirt, is shown from the chest up. Her face is partially obscured by a white speech bubble with a blue background. The speech bubble contains the text "MOS BINI PRE E MASHTRIMEVE" in white, pixelated, uppercase letters. The background is a solid dark blue color.

MOS BINI PRE E MASHTRIMEVE

Mëso si të kontrollosh së pari
#CheckitFirst

Në epokën e sotme digjitale, është vështirë të dish se cilave lajme t'u besosh. Dezinformatat po shpërndahen nëpër mediet në Ballkanin Perëndimor në një shkallë alarmante. Fuqitë e huaja dhe të brendshme, me agjendat e veta, po provojnë ta ndikojnë opinionin publik përmes rrëfimeve të rreme, manipuluese. **Por, e keni fuqinë t'i ndaloni këto lajme të rreme pa u bërë të mëdha. Me vetëm disa hapa, mund ta dalloni të vërtetën prej së rremes dhe ta ndaloni shpërndarjen e dezinformimit.**

Bëhuni pjesë e [#kontrollosepari](#), fushatës së re të ARTICLE 19, përmes së cilës promovohet gazetaria etike në Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Kjo pako e shkurtër informuese do t'ju pajisë me gjithçka që u duhet për të filluar.

PSE TANI?

Rajoni i Ballkanit Perëndimor është i prekur prej dezinformatave që dolën në pah prej krizave si COVID-19 dhe pushtimi rus në Ukrainë. Kjo cenueshmëri eksploatohet prej partive në pushtet dhe fuqive të jashtme si Kina dhe Rusia, të cilat synojnë ta manipulojnë opinionin publik. **Kur akterët e huaj manipulojnë informacionin në një mënyrë që i ndikon negativisht proceset politike, quhet Manipulim dhe Ndërrhyrje e Huaj në Informacion (MNHI)**

Mediet, të cilat duhet të konsiderohen si shtyllë e demokracisë, po përballen me sfida teksa sfidohen prej propagandës dhe clickbait. Organizatat mediale dhe gazetarët/et shpesh e kanë të vështirë t'i ruajnë standardet etike, gjë që mund të kontribuojë në shpërndarjen e dezinformatave.

DEZINFORMIMI V. KEQINFORMIMI

DEZINFORMATAT janë

- Informatat e pavërteta
- Qëllimshëm të krijuara për t'i çorientuar njerëzit

Dezinformatat mund të përdoren për të manipuluar perceptimin publik dhe për t'i ndikuar proceset politike.

KEQINFORMATAT janë

- Informatat e pavërteta
- Të shpërndara paqëllimshëm për shkak të keqkuptimeve, gabimeve dhe keqinterpretimeve.



ÇKA ËSHTE GAZETARIA ETIKE?

Gazetaria etike është vija e parë e mbrojtjes kundër dezinformimit. Kur gazetarët/et ndjekin parimet e profesionit të tyre, lajmet që ata/o i prodhojnë do të jenë të baraspeshuara dhe të sakta. **Këto parime janë:**

1. E VËRTETA & SAKTËSIA
2. PAVARËSIA
3. DREJTËSIA & PAANSHMËRIA
4. MOS SHKAKTO DËM
5. LLOGARIDHËNIA



Për më shumë, shih
[ARTICLE19 #CheckitFirst FAQ](#)



PESË HAPA PËR T'I DALLUAR LAJMET E RREME

Fuqizojeni veten, fuqizojeni kombin! Si qytetarë/e, ju keninëduarfuqinëpërtambajturçelësinqëdemaskon dezinformatat. Qëndroni të vëmendshëm/me, mos u çorientoni dhe ndërmerri hapa për t'i kundërshtuar lajmet e rreme.

Hapi 1: Kontrolloni burimin e informatës




Mësoni më shumë për uebfaqen apo platformën ku është botuar informata. Organizatat mediale të njohura dhe me reputacion kanë më shumë gjasa të ofrojnë informatë të saktë. Po ashtu, kontrolloni datën e botimit. Artikujt e vjetër shpesh mund të paraqiten sikur janë të rinj me qëllim që t'i çorientojnë lexuesit/et.

Hapi 2: Analizoni autorin/en



Hulumtoni rreth përgatitjes dhe punës së mëparshme të autorit/es. A ka ai/ajo histori të njëanshmërisë apo shpërndarjes së keqinformatave? Gjithnjë vini në pikëpyetje burimin, qëllimin e informatës dhe të dhënat e ofruara.

Hapi 3: Kërkoni lajme tjera



Verifikoni nëse lajmet janë raportuar në disa burime të besueshme. Nëse po, gjasat janë që lajmet të jenë të sakta. Mos u mashtroni prej titujve sensacionalistë. Lexoni përtej kryetitullit për ta kuptuar kontekstin e plotë.

Hapi 4: Verifikoni citatet dhe referencat



Lajmet e besueshme shpeshherë citojnë burimet. Mungesa e burimeve të besueshme mund të jetë shenjë e keqe. Kontrolloni origjinalitetin e çfarëdo fotografie apo citati duke përdorur mjete si mjete për kontrollimin e fotografive apo ueb-faqet për kontrollimin e fakteve.

Hapi 5: Kërkoni nga mediet që t'i respektojnë parimet e gazetarisë etike



Ju mund t'i mbani gazetarët/et llogaridhënës/e duke paraqitur ankesa te organet vetërregulluese të shtypit. Nëse vëreni shkelje të standardeve të gazetarisë etike, bëni që zëri juaj të dëgjohej.

Një mënyrë se si mund ta bëni këtë është që ta kontaktoni asocionin vendor të gazetarëve/eve ose të paraqisni ankesë te mekanizmat vetërregulluese të shtypit, në vendin tuaj përkatës:



Po ashtu, mund t'i kontaktoni platformat për kontrollimin e fakteve:

Bosnjë dhe Hercegovinë: [AFP Fact Check Europe](#), [Istinomjer](#)

Kosova: [ADS](#) dhe [Kallxo](#)

Mali i Zi: [AFP Fact Check Europe](#), [Raskrinkavanje](#)

Serbi: [AFP Fact Check Europe](#), [Fake News Tragac](#), [Istinomer](#), [Raskrinkavanje](#)



MJETE TË DOBISHME PËR VERIFIKIM



Ueb faqet për verifikim të fakteve: shfrytëzoni faqet që kanë reputacion në verifikim të fakteve si [Istinomjer](#) ose [Raskrinkavanje](#) (shih më lart) për t'i verifikuar pretendimet.



Verifikim/kërkim i fotografive/pamjeve: mjete si [Google Reverse Image Search](#) mund t'ju ndihmojnë të verifikoni origjinalitetin e pamjeve.




Shtesat e shfletuesit: instaloni shtesa si NewsGuard ose Fake News Detector për të marrë njoftime rreth besueshmërisë së faqeve të lajmeve.



Verifikimi i medieve sociale: shfrytëzoni mjetet verifikuese në platforma si X dhe Facebook për ta kontrolluar origjinalitetin e postimeve dhe profileve.

SI TË ANGAZHoheni ME LAJMET NË MËNYRË KRITIKE?



Parashtroni pyetje: gjithnjë vini në pikëpyetje burimin, qëllimin e informatës dhe të dhënat e ofruara.



Shumësoni burimet tuaja të lajmeve: mos u mbështetni në vetëm një burim për lajme. Lexoni nga shumë burime të besueshme për ta marrë një pikëpamje të plotë.



Edukoni veten: ndjekni kurse ose lexoni libra rreth shkathtësive mediale për t'i përmirësuar aftësitë tuaja.




Përfshihuni në diskutime: Merrni pjesë në diskutime dhe forume për të shkëmbyer pikëpamje dhe për ta sfiduar të të kuptuarit tuaj.

Në mënyrë që ta kundërshtoni efektivisht dezinformimin, është qenësore që t'i kuptoni kompleksitetet e tyre. Dezinformimi mund të ketë nuancë, të përziejë fakte me të paavërteta. **Duke edukuar veten rreth këtyre taktikave, ju mund ta identifikoni dhe ta demaskoni më lehtë informatën e pavërtetë. Përdorni të të menduarit kritik dhe kontrolloni nëpër shumë burime, ashtu që ta kuptoni të vërtetën.**



BËJE HAPIN SHITESË DHE KËRKO NGA GAZETARËT/ET TU/A TË PREFERUAR/A QË TA NËNSHKRUAJNË PËRKUSHTIMIN TONË



Ju e keni fuqinë që t'i mbani mediet llogaridhënëse. Vizitoni faqen tonë të përkushtimit për të parë se cilët/at gazetarë/e në vendin tuaj e mbështesin atë. Inkurajoni ata/o që ende nuk e kanë nënshkruar.

Për më shumë të dhëna rreth edukimit medial dhe rëndësinë e tij, vizitoni:

[ARTICLE19 MEDIA AND INFORMATION LITERACY](https://www.article19.org/)





KUR E MBANI MEDIEN TË PËRGJEGJSHME, JU
NDIHMONI NË RUAJTJEN E INTEGRITETIT NË
GAZETARI...

**MOS BINI PËRE
MASHTRIMEVE**

 **#CheckitFirst**

ARTICLE19



Financuar nga Bashkimi Evropian

**Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e
ARTICLE19 dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Bashkimit Evropian.**